



URDHËR

Nr. 76, datë 22.4.2022

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
DHE TË GRUPIT TEKNIK TË PUNËS PËR HARTIMIN
E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN
DHE QEVERISJEN VENDORE E TË PLANIT TË VEPRIMIT,
2023-2030**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të vendimit nr.867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe të planit të veprimit, 2023-2030.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për koordinimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës për financat vendore;
 - Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
 - Zëvendësministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Zëvendësministrin e Drejtësisë;
 - Zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit;

- Zëvendësministrin e Arsimit dhe Sportit;
- Zëvendësministrin e Kulturës;
- Përfaqësues nga ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
- Përfaqësues nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Përfaqësues nga kabineti i Zëvendëskryeministrit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës;
- Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- Përfaqësues nga shoqata e përfaqësuesve të vetëqeverisjes vendore.

3. Grupi ndërinstitucional i punës ka këto përgjegjësi:

- a) Diskutimin e gjetjeve mbi analizën e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe të planit të saj të veprimit, 2020-2022;
- b) Hartimin e planit të detajuar të punës dhe përcaktimin e afatit kohor për përgatitjen e Projektstrategjisë së re për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, 2023-2030;
- c) Diskutimin e vlerësimit të plotë të mangësive dhe nevojave për situatën e vetëqeverisjes vendore;
- ç) Shqyrtimin dhe miratimin paraprak të Projektstrategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe të planit të veprimit në zbatim të saj, 2023-2030.

4. Me ftesë të kryetarit, në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës, në varësi të çështjeve që do të diskutohen, ftohen të marrin pjesë ekspertë të huaj ose vendas, të angazhuar në hartimin e projektstrategjisë, përfaqësues të institucioneve të tjera, përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë, kombëtarë e ndërkombëtarë, të angazhuar në çështjet vendore.

5. Grupi teknik i punës të drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe të ketë në përbërje përfaqësues, në nivel drejtor i përgjithshëm/drejtor drejtorie/përgjegjës sektori dhe ekspertë, që kanë lidhje me çështje të funksioneve të deleguara të pushtetit vendor nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Kulturës;
- Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Shoqata e Përfaqësuesve të Vetëqeverisjes Vendore;
- Shoqata e Qarqeve.

6. Grupi teknik i punës të hartojë Projektstrategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe planin e veprimit për zbatimin e saj, 2023-2030, duke u mbështetur në rekomandimet e Bashkimit Evropian për këtë qëllim, SIGMA-s, OECD-së, si dhe në praktikat e modelet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe t’ia paraqesë për shqyrtim grupit ndërinstitucional të punës.
7. Grupi teknik i punës mund të organizohet, sipas nevojave, në grupe më të vogla sektoriale, sipas funksioneve dhe kompetencave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.
8. Kryetari i grupit teknik të punës t’i raportojë me shkrim dhe në çdo formë tjetër të përshtatshme kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike javore apo me kërkesë në çdo kohë mbi ecurinë e punës për hartimin e draftit paraprak të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, duke paraqitur, rast pas rasti, edhe projektin përkatës të strategjisë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.
9. Në takimet e grupit teknik të punës mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të tjera, pjesëmarrës ose jo në këtë grup pune, nga organizata ndërkombëtare, ekspertë në fushën e hartimit të politikave në fushën e pushtetit vendor, si dhe ekspertë të shoqërisë civile.
10. Grupi ndërinstitucional i punës dhe grupi teknik i punës mblidhen me njoftimin e kryetarit, në përputhje me kalendarin e takimeve e të veprimtarive dhe sa herë që vlerësohet e domosdoshme.

11. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore në Ministrinë e Brendshme kryejnë rolin e sekretariatit teknik të grupit ndërinstitucional të punës e të grupit teknik të punës.
12. Sekretariati teknik ka këto detyra:
 - a) Përmbledh materialet ekzistuese lidhur me monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015-2022;
 - b) Analizon mangësitë dhe nevojat për situatën e pushtetit vendor;
 - c) Koordinon punën me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), lidhur me metodologjinë e hartimit të projektstrategjisë, si dhe harmonizimin e saj me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI);
 - ç) Mban procesverbalet e çdo mbledhjeje dhe ua dërgon për nënshkrim përfaqësuesve të grupit ndërinstitucional dhe të grupit teknik të punës;
 - d) Ndihton e mbështet grupin ndërinstitucional të punës dhe grupin teknik të punës për përmbushjen e funksioneve të tyre, duke administruar procesin teknik për hartimin e Projektstrategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe planit të veprimit për zbatimin e saj;
 - d) Çdo detyrë tjetër të lënë nga mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës.
13. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë Kryeministrin lidhur me mbarëvajtjen e procesit të punës, në zbatim të këtij urdhri.
14. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikat 2 e 5, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre, pranë Ministrisë së Brendshme.
15. Sekretariati teknik të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dërgimi i emrave të përfaqësuesve nga institucionet e përmendura në pikat 2 e 5, të këtij urdhri.
16. Projektstrategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe plani i veprimit, 2023-2030, të hartohen brenda tremujorit të tretë të vitit 2022.

17. Shpenzimet financiare për aktivitetet e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës mbulohen nga buxheti i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe/ose financime nga donatorë.
18. Ngarkohen kryetarët, anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës e të grupit teknik të punës dhe institucionet që ata përfaqësojnë, si dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 2019/1
DATË 27.04.2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRIT TË SHTETIT PËR STANDARDET
E SHËRBIMEVE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE
FËMIJËT
AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT
STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË
NDIHMËS
AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA
AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT
TË TERRITORIT
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E
VETËQEVERISJES VENDORE
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE
SHKOLLËS SHQIPTARE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
SHOQATËS SË PËRFAQËSUESVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE
SHOQATËS SË QARQEVE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

